

MIRATOHET



M. 1435/prot
011.17.03.2016

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

STATUTI

I

FEDERATËS SHQIPTARE TË SPORTIT SHKOLLOR

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

NENI 1

FORMA LIGJORE, PËRBERJA, SELIA

1. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor (për efekt të këtij Statuti më poshtë do t'i referohemi FSHSSH) është person juridik privat që krijohet në formën e shoqatës, e cila perfaqëson bashkimin vullnetar të Shoqatave Rajonale të edukimit fizik dhe Sportit Shkollor në Republikën e Shqipërisë, që vepron në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, Ligjit nr. 8789 datë 07.05.2001 «Për rregjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse», Ligjit nr.9376, datë 21.04.2005 “Për Sportin”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor gëzon të drejtën për tu anëtarësuar në Federatën Ndërkombëtare të Sportit Shkollor dhe respekton statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e saj dhe siguron respektimin e tyre nga të gjithë anëtarët e saj.
3. Selia e saj ndodhet Rr. “Liman Kaba”, ish-Kompleksi “Dinamo”, Tiranë.

NENI 2

FLAMURI, EMBLEMA DHE LOGO

1. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor mban siglën FSHSSH.
2. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor ka stemën dhe flamurin e saj. Forma e logos është një shqiponje dhe në mes ndodhen gërmat FSHSSH.
3. Vula është e rumbullaket me stemën e Federates në qendër dhe anash në formë qarkore shkruan Federata Shqiptare e Sportit Shkollor.



NENI 3

QELLIMI DHE FUNKSIONET

1. Federata Shqiptare e Sportit Shkollorë është organizatë jofitimprurëse. Të ardhurat që krijohen në FSHSSH nga burime të ndryshme ligjore rinvestohen 100% për zhvillimin e aktivitetit të FSHSSH.
2. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor ka këto objektiva dhe detyra:
 - a. Të zhvillojë, promovojë, kontrollojë dhe rregullojë aktivitetin sportiv të shoqatave të FSHSSH, në të gjitha format e saj dhe në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë statut ;
 - b. Të zhvilloj marrëdhënie, miqësore midis anëtarëve të federatës si dhe të mbrojë të drejtat e anëtarëve të saj dhe të kujdeset për zgjidhjen e problemeve tekniko-organizative, sportive, duke u mbështetur në Statutin, Rregulloren e saj, legjislacionin shqiptar si dhe aktet ligjore ndërkombëtare të veprimtarisë së sportit shkollor.
 - c. Të shërbejë si koordinatorë, nxitëse dhe bashkëpunëtorë me organizmat qeveritare dhe joqeveritare qendrore dhe lokale për masivizimin dhe zhvillimin e lëvizjes fiziko –sportive, në sistemin arsimor, në përputhje me Platformën e edukimit fiziko-sportiv të Ministrisë Përgjegjëse për Sportin dhe Konventave ndërkombëtare dhe rajonale të fushës së edukimit fizik dhe sportit;
 - d. Të përfaqësojë dhe bashkëpunojë për të mbrojtur interesat e mësuesve të edukimit fizik dhe të kontribuojë për kualifikimin progresiv të tyre, nëpërmjet seminareve dhe aktiviteteve të ndryshme informuese dhe zhvilluese për fushën e edukimit fizik dhe sportit, në përputhje me standardet bashkëkohore.
 - e. Të kontribuojë për një zhvillim të gjithanshëm dhe harmonik fiziko lëvizorë, sportiv, funksional, psikologjik, intelektual, social, në funksion të shëndetit të rinisë shkollore, me qëllim aftësimin e tij përballë sfidave të jetës;
 - f. Të kontribuojë për ndërgjegjësimin e mënyrës së ushqimit, praktikimit të aktivitetit fizik dhe sportit, luftës kundër duhanit dhe përdorimit të substancave abuzive, luftës kundër dopingut në sport, ruajtjes dhe mirëmbajtjes së ambjentëve sportive në shkollë, si dhe të kushteve natyrore, si faktorë thelbësorë të rëndësishëm në cilësinë e shëndetit.
 - g. Të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës sportive në shkollë, për zhvillimin e lëndës së Edukimit fizik, në përputhje me standardet bashkëkohore.
 - h. Të nxisë dhe promovojë zhvillimin e të gjitha disiplinave sportive, si dhe aktivizimin e ekipeve të shkollave dhe talenteve respektive
 - i. Të bashkëpunojë me federatat e sportit shqiptar, për të bashkërenduar zhvillimin masiv dhe cilësor të ekipeve zinxhirë të disiplinave perkatëse.
 - j. Të programojë dhe organizojë zhvillimin e kampionateve të disiplinave të ndryshme sportive, midis shoqatave rajonale të sportit shkollor dhe të përfaqësojë Shqipërinë në aktivitetet sportive ndërkombëtare respektive.
 - k. Të nxisë dhe iniciojë bashkëpunime dhe shkëmbime eksperiencash, në fushën e edukimit fizik dhe sportit, brenda dhe jashtë vendit.
 - l. Të drejtojë dhe të kujdeset për mbarëvajtjen e të gjithë gjyqtarëve të FSHSSH, kombëtarë e ndërkombëtarë, të aderuar në Federatë;
 - m. Të organizojë në Republikën e Shqipërisë, veprimtari sportive shkollore ndërkombëtare dhe të japë leje për organizimin e tyre nga anëtarët e saj.



KREU II

NENI 4

ANËTARËSIA

1. Anëtarët e Federatës Shqiptare të Sportit Shkollor duhet të jenë persona juridikë, shoqata sportive, të cilat pranojnë aderimin pranë saj, duke respektuar statutin dhe rregulloret e funksionimit të FSHSSH.
2. Anëtarët e regjistruar në FSHSSH janë të detyruar të kontribuojnë për FSHSSH nëpërmjet pagimit të kuotizacioneve të përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Selia e një anëtari të FSHSSH është në territorin shqiptar.

NENI 5

E DREJTA E FITIMIT TË ANËTARËSISË

1. Pas regjistrimit në gjykatë si person juridik, shoqata kërkon të drejtën e anëtarimit në Federatën Shqiptare të Sportit Shkollor.
2. Komiteti Ekzekutiv i jep shoqatës të drejtën e të qenit anëtar provizor i FSHSSH deri në asamblenë e rradhës.
3. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi anëtarësinë e një anëtari, por ajo nuk mund ta refuzojë atë përderisa organizimi i kërkuesit nuk është në kundërshtim me statutin e FSHSSH.

NENI 6

TË DREJTAT E ANËTARËVE

Anëtari i Federatës Shqiptare të Sportit Shkollor ka të drejtë:

1. Të pajiset me kartën e anëtarësisë;
2. Të pajiset me statutin dhe rregulloret e Federatës Shqiptare
3. Të perfaqësohet me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme;
4. Të informohet me vendimet e Komitetit Ekzekutiv të Federatës;
5. Të pajiset falas me botimet e ndryshme që bën Federata;
6. Të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare e miqësore, kombëtare dhe ndërkombëtare që organizon FSHSSH;
7. Të njihet më parë me programin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe dokumentacionin përkatës.



NENI 7

DETYRIMET E ANËTARËVE

1. Të jetë korrekt ndaj FSHSSH, që nënkupton që çdo anëtar të mos ndërmarrë veprime kundër interesave të FSHSSH;
2. Te paguajë të gjitha detyrimet financiare ndaj FSHSSH;
3. T'i komunikojë FSHSSH çdo ndryshim në statutet dhe rregulloret e anëtarit si dhe listën e personave ose zyrtarëve me të drejtë firme për të hyrë në marrveshje ligjore me palet e treta;
4. Të pranojë dhe t'u nënshtrohet statuteve dhe rregulloreve të Federates Shqiptare të Sportit Shkollor dhe organizmave Nderkombetare të sportit shkollor;
5. Për Asamblenë e vet të Përgjithshme të zgjedhë organet drejtuese, ekzekutive dhe, nëse e gjykon të arsyeshme, dhe organin e vet disiplinor;
6. Te njohë parimet e ndershmërisë, integritetit dhe sjelljes korrekte sportive;
7. Te njohë të gjitha detyrimet e tjera që dalin nga këto statute, rregullore, direktiva dhe vendime të Federates;

NENI 8

PEZULLIMI

1. Shkelja serioze e statuteve, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FSHSSH i jep të drejtën Asamblesë së Përgjithëshme të pezullojë çdo anëtar të saj nga anëtarësimi në FSHSSH për një periudhë, e cila parashikohet nga AP;
2. Në raste urgjente, Komiteti Ekzekutiv mund të japë pezullim provizor deri në asamblenë e radhës, e cila do të shprehet me një vendim për vendimin e K.E-së;
3. Çdo vendim pezullimi përbën humbjen e të drejtave që lidhen me statusin e anëtarit për sa kohë që pezullimi mbetet në fuqi.

NENI 9

HUMBJA E STATUSIT TË ANËTARIT

1. Statusi i anetarit mbaron me dorëheqjen ose përjashtimin e anëtarit.
2. Humbja e statusit të anëtarit nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të papërmblushura kundrejt FSHSSH ose anëtarëve të tjerë. Pezullimi e përjashton atë nga të gjitha të drejtat që lidhen me FSHSSH, veçanërisht nga ato që lidhen me kapitalin e regjistruar në FSHSSH.



NENI 10

DORËHEQJA E ANËTARIT

Një anëtar mund të paraqesë me shkrim kërkesën e tij për dorëheqje me kusht që ajo të bëhet e vlefshme vetëm në fund të vitit financiar. Kërkesa duhet të paraqitet të paktën 30 ditë më pare.

KREU III

ORGANIZIMI

NENI 11

ORGANET E FEDERATËS SHQIPTARE TË SPORTIT SHKOLLOR

Organet e FSHSSH janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Presidenti;
- c) Komiteti Ekzekutiv;

Komisionet:

- a) Komisioni i disiplinës
- b) Komisioni i Apelit.
- c) Komisioni tekniko-arbital.
- d) Komisioni i finances.

NENI 12

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithëshme është organi më i lartë i Federatës Shqiptare të sportit shkollor. Vetëm një Asamble e mbajtur në përputhje me rregullat e këtij statuti, ka autoritetin të marrë vendime.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë anëtarët e saj, të cilët përfaqësohen me mandate, sipas përcaktimeve të nenit 15.
3. Mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithëshme pa të drejtë vote, anëtarët e nderit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv dhe Sekretari i Përgjithshem.
4. Komiteti Ekzekutiv vendos mbi pjesëmarrjen e personave të tjerë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.



5. Këta persona nuk kanë të drejte vote dhe mund të diskutojnë vetëm me leje të drejtuesit të Asamblesë.

NENI 13

KOPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme e FSHSSH ka këto kompetenca:

- a. Miraton ndryshime të statutit të FSHSSH në përputhje me Ligjin “Për Sportin” i ndryshuar.
- b. Miraton llogaritë vjetore të Federatës;
- c. Miraton raportin e Komitetit Ekzekutiv të FSHSSH.
- d. Voton buxhetin e FSHSSH.
- e. Miraton organin e kontrollit financiar të pavarur nga FSHSSH sipas ligjeve në fuqi.
- f. Përcakton numrin e plote të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.
- g. Zgjedh Presidentin e Federatës.
- h. Zgjedh anëtarët e Komitetit Ekzekutiv.
- i. Miraton propozimet e anëtarëve për dhënie të titujve të nderit brenda juridiksionit të federatës.
- j. Miraton pranimin, pushimin, pezullimin apo dorëheqjen e një anëtari sipas parashikimit në këtë statut.
- k. Heq mandatin e një anëtari apo të organeve të federatës sipas parashikimit në këtë statut.
- l. Deklaron shkrirjen e federatës dhe likuidimin e veprimeve të saj financiare.
- m. Miraton kalendarin e aktiviteteve të programuara nga K.E.

NENI 14

EMËRIMI I DELEGATËVE

Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të FSHSSH janë të detyruar të mbledhin Asamblenë e Përgjithshme të shoqatës, për të zgjedhur përfaqesuesit e tyre me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të FSHSSH.

1. Anëtarët (shoqatat) dërgojnë pranë federatës personat zyrtarë të autorizuar për përfaqësimin e tyre.
2. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin zyrtar (autorizim, prokurë) të shoqatës, që vërteton se ai është përfaqesues me të drejtë vote.
3. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin e identifikimit (pasaportë, kartën e identitetit, certifikatë);
4. E drejta e votës nuk mund t’i delegohet një anëtari tjetër.



5. Anëtarët (Shoqatat) janë të detyruar që të sjellin emrat e personave të autorizuar për t'u përfaqësuar me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme, pranë Sekretariatit të FSHSSH jo më vonë se 20 ditë përpara datës së zhvillimit të Asamblesë.

NENI 15

NUMRI DHE PËRCAKTIMI I DELEGATËVE

1. Numri i delegatëve përcaktohet si më poshtë:
 - a) Çdo shoqatë sportive rajonale e edukimit fizik dhe sportit shkollor ka 1 (një) delegat.
 - b) Shoqata sportive rajonale e edukimit fizik dhe sportit shkollor që mbulon aktivitetin shkollor nga 20 000 deri 30 000 nxënës ka të drejtën e 1 (një) delegati shtesë;
 - c) Shoqata sportive rajonale e edukimit fizik dhe sportit shkollor që mbulon aktivitetin shkollor nga 30 001 në 40 000 nxënës ka të drejtën e 2 (dy) delegatëve shtesë;
 - d) Shoqata sportive rajonale e edukimit fizik dhe sportit shkollor që mbulon aktivitetin shkollor nga 40 001 nxënës në 50 000 nxënës ka të drejtën e 3 (tre) delegatëve shtesë;
 - e) Shoqata sportive rajonale e edukimit fizik dhe sportit shkollor që mbulon aktivitetin shkollor mbi 50 000 nxënës ka të drejtën e 4 (katër) delegatëve shtesë.
2. Çdo delegat ka të drejtën e 1 (një) vote.
3. Nuk mund të përfaqësohet me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të FSHSSH:
 - a. Sekretari apo Drejtori Ekzekutiv i një shoqate sportive;
 - b. Persona që kanë qenë përfaqësues me të drejtë vote në një federatë tjetër.

NENI 16

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ZAKONSHME

1. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme thirret nga Komiteti Ekzekutiv jo më pak se një here në vit. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë duhet t'u dërgohet anëtarëve 30 ditë përpara datës së zhvillimit të saj.
2. Rendi i ditës vendoset nga K.E. Rendi i ditës, raportet e aktiviteteve, buxheti, llogaritë dhe çdo dokument tjetër duhet t'u dërgohet anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
3. Çdo anëtar ka të drejtën të propozojë përfshirjen në rendin e ditës të një çështje. Kjo kërkesë duhet të paraqitet në Sekretariatit e FSHSSH, 7 ditë përpara mbledhjes.

NENI 17

RENDI I DITËS PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË ZAKONSHME



Rendi i ditës për Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme duhet të përfshijë të paktën çështjet e mëposhtëme:

- a. Verifikimi i përbërjes së mbledhjes.
- b. Raporti i Presidentit.
- c. Miratimi i raportit të aktiviteteve të K.E-së.
- d. Miratimi i raportit financiar.
- e. Miratimi i veprimtarive financiare për vitin pasardhës.
- f. Zgjedhjet për çdo vend vakant.
- g. Shqyrtimi i propozimeve për amendamentet në statutin e FSHSSH.
- h. Diskutime nga anëtarët për çështje të tjera.
- i. Rendi i ditës mund të modifikohet nga një mazhorancë që përbën 2/3 e votave të shumicës (50%+1) para fillimit të punimeve të Asamblesë.

NENI 18

ASAMBLEJA E PERGJITHSHE E JASHTËZAKONSHME

1. K.E mund të thërrasë një Asamble të Përgjithshme të jashtëzakonshme nëse mendohet se kjo është e domosdoshme.
2. Kur të paktën 1/3 e delegatëve të Asamblesë së Federates bëjnë kërkesë me shkrim, K.E është i detyruar të thërrasë një Asamble të Përgjithshme të Jashtëzakonshme jo më vonë se 2 muaj pas marrjes së kërkesës. Nëse asambleja nuk mbahet, anëtarët që e kërkuan atë mund ta thërrasin mbledhjen vetë, duke ngarkuar një kryetar të përkohshëm me një grup pune.
3. Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme duhet t'u dërgohet anëtarëve 30 dite përpara ditës së zhvillimit të saj.
4. Rendi i ditës si dhe çdo dokument tjetër duhet tu dërgohen anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
5. K.E vendos për rendin e ditës kur Asamblenë e thërret ai. Kur ajo mbahet me kërkesën e 1/3 të delegatëve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga këta anëtarë.
6. Rendi i ditës nuk mund të ndryshohet për çfarëdolloj kushtesh.

NENI 19

VENDIMMARRJA

1. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme kur janë prezent më shumë se gjysma e delegatëve (50%+1) që kanë të drejtë të votojnë, me përjashtim të pikës 2 të këtij neni.
2. Nëse shumica e thjeshtë (50%+1) nuk arrihet, një Asamble tjetër e Përgjithshme duhet të bëhet 24 orë pas të parës, me të njëjtin rend dite. Nuk kërkohet shumicë për mbledhjen e dyte, përveç rasteve kur në rendin e ditës janë parashikuar amendamente në statutin e FSHSSH, si zgjedhja e Presidentit dhe e K.E-



së, lirimi i një ose disa anëtarëve të një organi të FSHSSH, përjashtimi i një anëtari të FSHSSH ose shkrimi e FSHSSH, për të cilën kërkohet një mazhorancë prej 2/3 e votave të dala nga votimi i delegatëve prezent.

3. Asambleja e Përgjithshme nuk duhet të marrë vendime për çështje që nuk janë parashikuar në rendin e ditës.
4. Anëtarët ushtrojnë të drejten e votimit të tyre përmes delegateve të tyre zyrtarë. Një delegat nuk mund të përfaqësojë me shumë se një anëtar.
5. Vendimet duhet të merren me votim të hapur me përjashtim të rastit kur 1/3 e delegatëve kërkojnë votim të fshehtë. Në rast të votave të barabarta, vota e Presidentit është përcaktuese kur votimi është i hapur.
6. Votimi me prokurë nuk lejohet.
7. Vendimet e marra nga Asambleja hyjnë në fuqi një ditë pasi ato janë miratuar, me përjashtim të rasteve kur Asambleja vendos për një datë më të mëvonshme, ose ia delegon këtë të drejtë K.E-së.

NENI 20

DREJTIMI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme duhet të drejtohet nga Presidenti ose, në mungesë të tij, nga një zëvendëspresident. Kur edhe ai mungon, mbledhja drejtohet nga anëtari më i vjetër i K.E duke u emëruar Kryetar i ditës.
2. Asambleja cakton komisionin e numërimit të votave të përbërë nga 3-5 persona.
3. Drejtuesi i mbledhjes është përgjegjës për respektimin e rendit të ditës. Ai përcakton edhe kohën në dispozicion të çdo anëtari për diskutim.
4. Procedura e mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili i dërgon ato tek anëtarët brenda 20 ditëve mbas datës së mbledhjes.

NENI 21

ZGJEDHJET

1. Zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë.
2. Zgjedhjet (me përjashtim të Presidentit) duhet të bëhen mbi bazën e (50%+1) të votave të delegatëve të pranishëm në raundin e parë, dhe pastaj, në bazë të një numri më të madh të votave në raundin e dytë. Në rast se votat janë të njëjta bëhet një raund tjetër për të ndarë kandidatët, i cili përsëritet jo më shumë se tre herë. Në rast se përsëri ky votim është i njëjtë, kandidatët duhet të përcaktohen nga shorti, i cili organizohet nga komisioni i numërimit të votave.
3. Zgjedhja e Presidentit të Federates ka nevojë për 2/3 e votave të delegatëve të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur asnjë nga kandidatët nuk arrijnë 2/3 atëherë dy kandidatët që kanë marrë numrin më të madhë në raundin e parë kualifikohen për raundin tjetër. Në raundin tjetër, kandidati me numrin më të



madh të votave zgjidhet. Në rast se numri i votave në raundin e dytë është i barabartë atëherë zbatohen rregullat e përcaktuara në pikën 2.

4. Çdo kandidat duhet të propozohet nga të paktën një anëtar i FSHSSH, jo më vonë se 20 ditë para datës së asamblesë, në rendin e ditës të së cilës është vendosur zgjedhja e K.E-së. Secili kandidat duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme.

NENI 22

PRESIDENTI

Kandidati për President duhet:

- të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;
- të ketë arsim të lartë;
- të ketë figurë të pastër morale;
- të ketë moshën mbi 30 vjeç;
- të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj;
- të mos ketë konflikt interesash me postin e presidentit;
- të ketë kontribuar mundësisht në fushën e sportit si sportist, trajner, gjyqtar, gazetar, apo donator (financues).

NENI 23

DETYRAT E PRESIDENTIT

Detyrat e Presidentit janë si më poshtë:

- a. Të përfaqësojë FSHSSH si i vetmi përfaqësues i saj;
- b. Të kërkojë thirrjen e A.P dhe të thërrasë mbledhjet e K.E-së;
- c. Të drejtojë Asamblenë e Përgjithshme po ashtu edhe takimet e K.E-së;
- d. Të sigurojë zbatimin e vendimeve të A.P dhe të K.E-së;
- e. Në rast se Presidenti mungon, detyrat mund t'i ngarkohen Zëvendëspresidentin;
- f. Në rastin kur Presidenti jep dorëheqjen, K.E cakton një zëvendëspresidentin të kryejë funksionet e Presidentit për kohësisht, deri në thirrjen urgjente të Asamblesë së Jashtëzakonshme.

NENI 24

KOMITETI EKZEKUTIV

1. Komiteti Ekzekutiv përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) vetë, përfshirë Presidentin, zëvendëspresidentin dhe anëtarët e tjerë.



- a. Kandidati për anëtar i Komitetit Ekzekutiv duhet:
- Të jetë shtetas shqiptar me banim në Shqipëri;
 - Të ketë arsim të lartë;
 - Të ketë figure të pastër morale;
 - Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj;
 - Të mos jetë njëkohesisht trainer, gjygtar, vëzhgues, sekretar klubi apo anëtar i një organi gjykues të FSHSSH;
 - Të mos jetë njëkohesisht anetar i nje federate tjetër (anetar komisioni, kolegumi etj);
 - Të mos jetë i denuar nga nje federate sportive për thyerje disiplinë, abuzim financiar apo përdorim doping;
 - Të jetë i propozuar nga nje anetar i federatës (shoqate anëtare);
 - Të mos ketë konflikt interesi me të qenit anëtar i K.E-se.
 - Të ketë ushtruar një nga sportet që përfshihen në veprimtarinë e kësaj Federate.
2. Anëtarët që e propozojnë kandidatin nuk duhet të jenë të pezulluar.
3. Emrat e kandidatëve, bashkë me kurikulumin e tyre duhet të dërgohen nga anëtarët në Sekretariatit e Përgjithshëm të FSHSSH. Sekretariati i Përgjithshëm verifikon kandidaturat dhe ia paraqet rezultatet K.E-së për miratim. Lista e aprovuar e kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet, i paraqitet delegatëve së bashku me rendin e ditës së Asamblesë. Për këtë veprimtari K.E duhet të ngrejë një komision të posaçëm për seleksionimin e kandidaturave sipas kriterëve të përcaktuara në këtë statut.
4. Çdo anëtar i FSHSSH propozon 1 (një) kandidatë për anëtar në K.E. Shoqata që mbulon aktivitetin në Kryeqytet ka të drejtë të porozojë 2 (dy) kandidatë për anëtar në K.E.

NENI 25

KOHEZGJATJA E MANDATEVE

1. Mandati i Presidentit, Zv/ Presidenti, Sekretarit të Përgjithshëm dhe anëtarëve të tjerë të Komitetit Ekzekutiv është 4 vjeçar. Ata kanë të drejtë të rikandidojnë, por jo më shumë se dy mandate.
2. K.E plotëson vendin e mbetur vakant të anëtarit të tij në mbledhjen e Asamblesë së radhës nëpërmjet votimit, si parashikohet në statut për zgjedhjet e FSHSSH.

NENI 26

MBLEDHJET

1. K.E mbledhet jo më pak se gjashtë herë në vit.
2. Mbledhja drejtohet nga Presidenti.
3. Presidenti bën njoftimin për mbledhje 14 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes. 1/3 e anëtarëve të K.E-së i kërkojnë Presidentit mbledhjen e K.E-së jashtë radhe. Presidenti duhet të mbajë mbledhjen brenda 3 (tre) javëve pas marrjes së kërkesës;



4. Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë pjesë në takimet e K.E pa të drejtë vote.
5. Mbledhjet e K.E-së nuk mbahen në publik. K.E mund të ftojë palë të treta të marrin pjesë. Këto palë të treta nuk kanë të drejtë votimi dhe mund të shprehin opinionin e tyre vetëm me miratimin e Presidentit të FSHSSH.
6. Për mbledhjet e K.E. mbahet proces-verbal, i cili firmoset nga Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm dhe nga çdo anëtar i Kryesisë pjesmarrës në mbledhje dhe vendimet duhet të zbardhen brenda pesë (5) ditëve dhe të bëhen publike.
7. Procesverbalit i mbledhjes ruhet në arkiv në dy kopje. Për dëmtimin, falsifikimin apo humbjen e proces-verbalit, përgjegjësit mbajnë përgjegjësi ligjore.

NENI 27

KOMPETENCAT E KOMITETIT EKZEKUTIV

K.E ka këto kompetenca:

- a. Të menaxhojë dhe drejtojë punët e FSHSSH;
- b. Të planifikojë aktivitetet dhe kalendarin e veprimtarive;
- c. Të përcaktojë për secilin punonjës të FSHSSH specifikat e punës;
- d. Të monitorojë administrimin e FSHSSH;
- e. Të zgjedhë zëvendës-presidentin,
- f. Të përgatisë dhe të mbajë Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme;
- g. Të hartojë projektbuxhetin;
- h. Të emërojë dhe të shkarkojë anëtarët e organeve gjyqesore.
- i. Të emërojë dhe kur e sheh të arësyeshme të shkarkojë anëtarët e Komisioneve të përherëshme;
- j. Të përcaktojë, organizojë dhe anullojë aktivitete zyrtare të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar;
- k. Të mbajë lidhje me organizata sportive kombëtare dhe ndërkombëtare dhe gjithashtu të ushtrojë të drejtën për të propozuar perfaqesues të FSHSSH për t'u zgjedhur në këto organizata.

NENI 28

VENDIMMARRJA

1. K.E fillon mbledhjet vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij;
2. K.E merr vendime me 50%+1 të anëtarëve të pranishëm. Në rastin e votave të barabarta, Presidenti ka votë vendimtare kur votimi është i hapur;
3. Në rast se një anëtar i K.E-së ka konflikt interesash me çështjen për të cilën debatohet, ai perjashtohet nga debati dhe votimi për këtë çështje;
4. Vendimet e marra rregjistrohen në procesverbal;
5. Vendimet e marra nga K.E. hyjnë në fuqi menjëherë, përveç rasteve kur K.E vendos ndryshe.



KREU VI

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

NENI 29

1. Sekretari i Përgjithshëm është organi administrativ i FSHSSH.
2. Ministri përgjegjës për Sportet miraton njërën nga dy kandidaturat për Sekretar të Përgjithshëm të propozuara nga K.E i FSHSSH, i cili do të administrojë fondin grant të dhënë nga Ministria Përgjegjëse për Sportin dhe veprimtarine financiare të FSHSSH.
3. Sekretari i Përgjithshëm mund të pezullohet nga K.E për shkelje të rënda statutore apo abuzime të ndonjë natyre tjetër:
 - a. Kandidati për Sekretar të Përgjithshëm duhet:
 - Të jetë shtetas shqiptar me banim në Shqipëri;
 - Të ketë arsim të lartë, mundësisht jurist apo ekonomist, apo kualifikime të vërtetuara për menaxhim;
 - Të ketë figure të pastër morale;
 - Të ketë moshën mbi 30 vjeç;
 - Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj;
 - Të mos jetë njëkohësisht trajner, gjyqtar, vëzhgues, sekretar klubi apo anëtar i një organi gjykues të FSHSSH;
 - Të mos jetë njëkohësisht anëtar i një federate tjetër (anëtar komisioni, kolegjumi, etj);
 - Të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare;
 - Të mos ketë konflikt interesash me të qenit Sekretar i Përgjithshëm.
4. Funkcionet e tij janë:
 - a. Të zbatojë vendimet e Komitetit Ekzekutiv.
 - b. Të bëjë përgatitjet për Asamblenë e Përgjithshme dhe për mbledhjet e organeve të tjera dhe komisioneve.
 - c. Të programojë rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme dhe të takimeve të K.E-së.
 - d. Të mbajë korrespondencën e FSHSSH.
 - e. Të mbajë librat e llogarisë së FSHSSH.
5. Sekretari i Përgjithshëm është drejtues i Sekretariatit të FSHSSH.
6. Ai është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e sekretariatit të përgjithshëm dhe për menaxhimin e stafit që punon brenda tij.
7. Ai merr pjesë rregullisht në Asamblenë e Përgjithshme, takimet e K.E-së dhe në ato të komiteteve këshilluese në një rol këshillues. Nëse ai nuk është në gjëndje të marrë pjesë, duhet të caktojë një zëdhënës.
8. Të informojë strukturat përkatëse shtetërore për menaxhimin e grantit, financimeve apo lehtësimeve fiskale që bën shteti për FSHSSH.



NENI 30

PERJASHTIMI I NJË PERSONI TË ZGJEDHUR

1. K.E mund të pezullojë një anëtar të K.E-së për shkelje statuore, abuzime financiare të faktuara nga organi kompetent apo për ndonjë shkelje apo veprim tjetër që K.E e çmon si ngjarje të rëndësishme.
2. Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin që ta përjashtojë një anëtar kur propozimi për përjashtim votohet me 2/3 e anëtarëve të plotë që përbëjnë Asamblenë e Përgjithshme të FSHSSH.
3. Kur 1/3 e anëtarëve që përbën Asamblenë e Përgjithshme kërkon përjashtimin e presidentit për një arsye të paraqitur në mocionin e mosbesimit. Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin për të marrë vendimin ose jo të përjashtimit, kur ky propozim votohet me 2/3 e anëtarëve të numrit të përgjithshëm që përbëjnë asamblenë.
4. Mocioni i paraqitur nga 1/3 e anëtarëve për çfarëdo problemi qoftë, ai është detyrues për K.E-në e Federatës për të mbledhur Asamblenë e Përgjithshme.

KREU VII

FINANCA

NENI 31

PERIUDHA FENANCIARE

I. Periudha financiare do të jetë viti kalendarik.

NENI 32

BURIMET FINANCIARE

Të ardhurat e FSHSSH sigurohen nga :

- a. Granti i përcaktuar nga Ministria Përgjegjëse për Sportin;
- b. Rregjistrimet vjetore të anëtarëve;
- b. Të ardhurat e krijuara nga marketingu i të drejtave që gëzon FSHSSH;
- c. Nga sponsorizimet, donacionet, dhurimet, financimet nga shteti dhe burime të tjera të lejuara;
- d. Nga liçensimi i trajnerëve, sportistëve, gjyqtarëve, mjekëve, specialistëve, amatorëve.



KREU VIII

DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 33

1. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut ose që ndodhin për çështje të forcave madhore, do të zgjidhen duke iu referuar dispozitave të Ligjit nr. 9376, datë 21.04.2005 “Per Sportin” i ndryshuar, Kodit Civil, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Per Organizatat Jofitimprurëse” si dhe Ligjit 8789, datë 07.05.2001 “Për rregjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Çdo ndryshim i statutit të Federatës Shqipëtare të Sportit Shkollor përpara se të rregjistrohet në Gjykatën përkatëse, miratohet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për sportet.
3. Në rast mosmarrëveshjes brenda FSHSSH, të cilat çojnë në paralizimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së FSHSSH, Ministri përgjegjës për sportin ka të drejtë të pezullojë veprimtarinë e organeve drejtuese të FSHSSH dhe të emërojë me mandat të përkohshëm një Kryetar të FSHSSH, për të drejtuar veprimtarinë e kësaj Federate dhe për të përgatitur thirrjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme Zgjedhore.

Ky Statut është miratuar nga Asambleja e Pergjithshme e FSHSSH.

